




Shkruan: Ibrahim GASHI



VOTAT RINUMËROHEN, KOHA PËR INSTITUCIONET SHKURTOHET

FAQE 4-5



Në kohën kur dukej se Kosova po shkonte drejt formimit të institucioneve të reja pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit, procesi zgjedhor u kthye disa hapa mbrapa. Zbulimi i mospërputhjeve serioze në votat e kandidatëve për deputetë e detyroi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të marrë vendim për rinumërim të plotë të të gjitha votave në vendvotimet e rregullta. Për vëzhguesit e proceseve zgjedhore dhe zhvillimeve politike në Kosovë, ky vendim ishte i domosdoshëm për mbrojtjen e integritetit të votës, njëkohësisht hap rrezikun e vonesave të gjata procedurale dhe të një krize të mundshme institucionale

LDK-ja THËRRET KUVENDIN E PARTISË MË 31 JANAR, ABDIXHIKU PRITET TË KËRKOJË VOTËBESIM

F. 3



FTESA E TRUMPIT PËR PJESËMARRJEN NË "BORDIN E PAQES", RAMA: DO T'I PËRCILLET KUVENDIT PËR MIRATIM

F. 7



SËRISH PROBLEME ME RRYMË NË KOSOVË

F. 8

AKB-ja ALARMON: VENDIMI PËR PAGËN MINIMALE U BË PA DIALOG DHE PO SHTYN BIZNESET DREJT INFORMALITETIT

F. 8

SPORT



KOSOVA NGJITET NË POZITËN E 79 NË RANGLISTËN E FIFA-S

F. 11

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

KUSH ËSHTË DIPLOMATI QË TRUMPI E EMËROI PËRFAQËSUES I LARTË PËR GAZËN?

WASHINGTON, 20 JANAR - Diplomati bullgar dhe ish-ministri i Jashtëm, Nikolay Mladenov, do ta udhëheqë administratën kalimtare në Rripin e Gazës, konfirmoi të premten Shtëpia e Bardhë. Sipas njoftimit, Mladenov do ta mbajë pozitën e përfaqësuesit të lartë për Gazën. Lajmi vjen tre muaj pas arritjes së një marrëveshjeje armëpushimi në Gazë ndërmjet Izraelit dhe Hamasit - grupit që qeveris Gazën dhe konsiderohet terrorist nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian. Marrëveshja u arrit me ndërmjetësimin e Shteteve të Bashkuara dhe ishte hapi i parë i planit të presidentit amerikan, Donald Trump, për t'i dhënë fund luftës në Gazë.

Emërimi i një administrate kalimtare në enklavë është pjesë e këtij plani.

Në rolin e tij si përfaqësues i lartë për Gazën, Nikolay Mladenov, “do të veprojë si lidhje në terren” ndërmjet Bordit për Paqe - një strukturë që ShBA-ja po e krijon për të ushtruar përkohësisht kontroll mbi qeverisjen e Gazës - dhe Komitetit Kombëtar për Administrimin e Gazës, i cili do të funksionojë si qeveri e përkohshme, nën mbikëqyrjen e Bordit për Paqe, thuhet në njoftimin e Shtëpisë së Bardhë. Ai “do ta mbështesë mbikëqyrjen e Bordit në të gjitha aspektet e qeverisjes, rindërtimit dhe zhvillimit të Gazës”, thuhet në njoftim.

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, u takua me të, më herët në janar, dhe tha se ai do ta udhëheqë autoritetin kalimtar në Gazë.

Në të kaluarën Mladenov ka shërbyer si ministër i Mbrojtjes dhe ministër i Punëve të Jashtme i Bullgarisë, ka qenë deputet dhe eurodeputet. Po ashtu, ka mbajtur poste të larta në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe ka përvojë në ndërmjetësimin në mes të Izraelit dhe Hamasit.

Deputet, eurodeputet, ministër...

Nikolay Mladenov ka lindur më 5 maj të vitit 1972 në Sofje. Ai ka përfunduar studimet për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin për Ekonomi Kombëtare dhe Botërore në Sofje dhe ka një diplomë master në Shkenca Ushtarake nga Kolegji Mbretëror në Londër.

Karrierën politike e ka nisur në Bashkimin e Forcave Demokratike (SDS), ku ka shërbyer edhe si zëdhënës i partisë.

Në vitin 2001 ai është zgjedhur deputet në Kuvendin e 39 të Bullgarisë nga radhët e ODS-së.

Pas përfundimit të mandatit në vitin 2005, ai ka punuar si konsulent për Bankën Botërore dhe për organizata të tjera ndërkombëtare në Evropën Juglindore dhe Lindjen e Mesme, thuhet në biografinë e tij zyrtare.

Para se është emëruar ministër i Jashtëm, Mladenov ka qenë anëtar i Parlamentit Evropian. Ai është zgjedhur në vitin 2007 nga lista e partisë GERB dhe ka qenë ndër eurodeputetët e parë bullgarë pas anëtarësimit të Bullgarisë në Bashkimin Evropian.

Në vitin 2009 ai i është bashkuar qeverisë së parë të Boyko Borisovit si ministër i Mbrojtjes.

Një vit më vonë, më 2010, është emëruar ministër i Punëve të Jashtme, duke zëvendësuar Rumjana Zhelevën pas dorëheqjes së saj, dhe e ka mbajtur këtë pozitë deri në përfundimin e mandatit të qeverisë së GERB-it në vitin 2013. Ai e ka mbajtur këtë pozitë gjatë periudhës së Pranverës Arabe, një valë protestash dhe kryengritjesh në vendet arabe që kanë nisur në vitin 2010 - disa prej të cilave janë shndërruar edhe në luftëra civile.

Në vitin 2012 Mladenov ka organizuar në Bullgari një takim të opozitës siriane, ku kanë marrë pjesë grupe të ndryshme kundërshtarë të regjimit të atëhershëm të Bashar al-Assadit.

Veprimtaria në Lindjen e Mesme

Në vitin 2013 atëkohë sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Ban Ki-moon, e ka emëruar Nikolay Mladenovin përfaqësues i posaçëm të Kombeve të Bashkuara për Irakun.

Ky emërim është bërë në një periudhë kur siguria në këtë vend ka qenë seriozisht e rrezikuar nga përplasjet mes qeverisë dhe grupeve të armatosura.

Në vitin 2015, Mladenov është emëruar koordinator i OKB-së për procesin e paqes në Lindjen e Mesme - post që e ka mbajtur deri në vitin 2020. Ai ka ndërmjetësuar në mes të Izraelit dhe Hamasit gjatë një periudhe të tensionuar dhe ka mbështetur idenë e zgjidhjes së konfliktit përmes negociatave, ka shkruar Associated Press (AP) në një publikim në fillim të janarit.

Agjencia ka cituar diplomatë që kanë thënë se puna e tij ka fituar besimin si të përfaqësuesve izraelitë, ashtu edhe të atyre palestinezë.

Sipas diplomatit të pensionuar izraelit, Alon Bar, Mladenov arriti “të krijojë marrëdhënie besimi me nivelin politik në Izrael, përfshirë kryeministrin Netanyahu”. Njëkohësisht, “ai fitoi besim të madh edhe nga pala palestineze”, ka thënë ai për AP-në.

Ish-ministri palestinez Ahmed Majalani është cituar të ketë thënë se Mladenov “na njeheve dhe i njehe shumë mirë izraelitët - gjë që është një avantazh i madh”. Në vitin 2021 Mladenov ka marrë një çmim nga presidenti i Autoritetit palestinez, Mahmoud Abbas, për kontributin e tij në paqen në Lindjen e Mesme.

Në vitin 2020 Mladenov është propozuar nga sekretari i përgjithshëm i OKB-së, Antonio Guterres, si përfaqësues i OKB-së në Libi, dhe emërimi i tij është miratuar nga Këshilli i Sigurimit. Megjithatë, ai e ka tërhequr



kandidaturën, duke cituar arsye personale.

Dosjet “Pandora”

Nikolay Mladenov është një nga dy bullgarët, emrat e të cilëve janë përfshirë në hetimin ndërkombëtar gazetaresk Dosjet “Pandora” në vitin 2021. Atëherë faqja BIRD ka raportuar se Mladenov ka regjistruar një kompani ‘offshore’, apo jashtë shtetit, e cila nuk ka pasur aktivitet, por ai nuk e ka deklaruar. Sipas medieve, kompania “Afron Enterprises Ltd.”, është themeluar më 9 gusht të vitit 2013, ndërsa disa ditë më parë - më 2 gusht 2013 - ai është emëruar përfaqësues i OKB-së në Irak.

Mladenov ka konfirmuar ekzistencën e kompanisë, por ka thënë se ajo nuk ka funksionuar, sepse planet e tij për biznes kanë ndryshuar pas regjistrimit dhe ai ka filluar punë në OKB. Ai nuk ka mundur t'i kujtonte saktësisht procedurat dhe datat e regjistrimit gjatë intervistës për BIRD-in.

Sipas AP-së, Mladenov aktualisht jeton në Emiratet e Bashkuara Arabe, ku punon si drejtor i përgjithshëm i Akademisë Diplomatike “Anwar Gargash”. Është i martuar dhe ka tre fëmijë.

Si do të qeveriset Gaza?

Plani 20-pikësh i Trumpit për t'i dhënë fund luftës në Gazë

parashikon që enklava të administrohet nga një qeveri e përkohshme, e quajtur Komiteti Kombëtar për Administrimin e Gazës. Ky komitet do të mbikëqyrret nga Bordi për Paqe, përbërja e të cilit u bë publike të premten nga Shtëpia e Bardhë.

Sipas njoftimit, Trumpi do të jetë kryetar i Bordit, ndërsa pjesë e tij janë gjithashtu: sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, i dërguari special Steve Witkoff, ish-kryeministri britanik Tony Blair, dhëndri i Trumpit, Jared Kushner, miliardi dhe drejtori ekzekutiv i fondit të investimeve Apollo Global Management, Marc Rowan, presidenti i Bankës Botërore, Ajay Banga, dhe këshilltari i Trumpit, Robert Gabriel.

Plani i ShBA-së parashikon, gjithashtu, çarmatosjen e Hamasit dhe vendosjen e forcave ndërkombëtare në Gazë. Komandant i tyre është emëruar general-major Jasper Jeffers, ish-komandant i operacioneve speciale të ShBA-së, njoftoi Shtëpia e Bardhë.

Plani ka marrë mbështetje të gjerë në OKB, ku është miratuar një rezolutë që autorizon forcat ndërkombëtare të stabilizimit për të garantuar sigurinë në Gazë, aprovon administratën kalimtare nën kontrollin e Trumpit dhe parashikon një mundësi të ardhshme për një shtet të pavarur palestinez.

Plani i ShBA-së hyri në fuqi në tetor, pas arritjes së një armëpushimi ndërmjet Izraelit dhe Hamasit, të cilët luftuan për më shumë se dy vjet

Lufta nisi pasi Hamasi sulmoi Izraelin në vitin 2023, duke vrarë mbi 1 200 njerëz dhe duke marrë qindra pengje. Në përgjigje, Izraeli filloi bombardime në Gazë dhe më pas vendosi bllokadë totale të enklavës, duke shkaktuar uri masive. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë, e cila udhëhiqet nga Hamasi, numri i viktimave ka kaluar 70 000.

SPANJA SHPALL TRI DITË ZIE, TEKSA RRIKET NUMRI I VIKTIMAVE NGA PËRPLASJA E TRENAVE

MADRID, 20 JANAR - Nga e marta për tri ditë rresht në Spanjë është shpallur ditë zie në nderim të 40 personave që u vranë pasi dy trena të shpejtë u përplasën gjatë fundjavës.

Përplasja e trenave, që ndodhi të dielën mbrëma, është aksidenti më vdekjeprurës në Spanjë që nga viti 2013, kur 80 persona vdiqën pasi një tren doli nga shinat në qytetin Santiago de Kompostela.

Aksidenti i fundit ndodhi kur një tren që po operohej nga kompania Iryo, që po udhëtonte nga Malaga për në Madrid, doli nga shinat afër Adamuzit në



rajonin jugor të Andaluzisë. Treni doli në anën tjetër të shinave dhe u përplas me një tren që po vinte nga drejtimi i

kundërt. “Kjo është një ditë e dhimbjes për gjithë Spanjën, për gjithë kombin”, tha kryeministri Petro Sanchez,

gjatë një adresimi për gazetarë kur qëndroi në Adamuz të hënën dhe njoftoi për shpalljen e tri ditëve të zisë. “Ne do të marrim përgjigje dhe sapo të kuptohet shkaku i tragjedisë dhe ne do të njoftojmë për të me transparencë absolute”.

Dyzet persona janë konfirmuar se kanë vdekur si pasojë e përplasjes, tha kreu i qeverisë rajonale në Andaluzi, Juan Manuel Moreno. Shifrat paraprake të paraqitura nga autoritetet spanjolle thoshin se 39 persona kishin humbur jetën në aksident.

Moreno shtoi se do të duhen 24

- 48 orë “për të ditur me siguri se sa vdekje u shkaktoan nga ky aksident i tmerrshëm”.

Makineri të rënda u dislokuan në vendngjarje të hënën për t'i larguar vagonët e dëmtuar të trenave dhe për t'iu mundësuar qasje ekepeve të shpëtimit.

Më shumë se 120 persona janë të lënduar si pasojë e aksidentit dhe 41 janë ende në spitalet në qytetin Kordoba, tha Moreno. Familjarët dhe miqtë e pasagjerëve të zhdukur kanë përdorur rrjetet sociale për t'i publikuar fotografitë e më të dashurve të tyre në përpjekje për t'i gjetur.

FTESA E TRUMPIT PËR PJESËMARRJEN NË ‘BORDIN E PAQES’, RAMA: DO T’I PËRCILLET KUVENDIT PËR MIRATIM

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

TIRANË, 20 JANAR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, përmes një postimi në rrjetet sociale, ka njoftuar të martën se i ka kthyer përgjigje presidentit amerikan, Donald Trump, lidhur me ftesën për të marrë pjesë në “Bordin e Paqes” për Gazën.

Rama ka bërë me dije se kjo ftesë do t’i përcillet Kuvendit të Shqipërisë për miratim.

Kryeministri Rama ka falënderuar Trumpin për ftesën teksa e ka cilësuar nismën e presidentit amerikan si një model transformues të ndërtimit të paqes në nivel global. “Sot i përcolla presidentit Donald J. Trump përgjigjen e ftesës së tij për të marrë pjesë në Bordin e Paqes. Po ju shkruaj për ta shprehur vlerësimin tim më të thellë për angazhimin tuaj të fortë dhe udhëheqjen vizionare në themelimin e Bordit të Paqes, si edhe për t’ju falënderuar

sinqerisht për ftesën që më keni drejtuar personalisht për të qenë pjesë e tij, si edhe për ftesën drejtuar vendit tim, Republikës së Shqipërisë, për të shërbyer si anëtare themeluese. Në një kohë kur konfliktet dhe përçarja dominojnë shumë shpesh panoramën ndërkombëtare, paqja duhet të formësohet aktivisht e jo të pritët pasivisht a diskutohet pafundësisht nëpër forume politike, teksa përreth globit jetë të pafajshme humbasin kotësisht çdo minutë. Bordi i Paqes shfaqet si mishërim i kësaj domosdoshmërie urgjente. Duke trajtuar njëkohësisht pasojat e menjëhershme të konflikteve dhe shkaqet më të thella strukturore që e prodhojnë paqëndrueshmërinë, kjo nismë ka potencialin të shndërrohet në një model vërtetë transformues të ndërtimit të paqes në nivel global.

Duket qartë se për të qenë një organizatë e re ndërkombëtare, Bordi i Paqes nuk është konceptuar si një forum tjetër



deklaratash, procedurash dhe përgjegjësish të shtyra në kohë, por si një instrument i përqendruar dhe qëllimplotë i udhëheqjes dhe përgjegjësisë globale. Kur filtrohet pafundësisht përmes shtresave të procedurave, paqja shumë shpesh mbërrin tepër vonë; kjo nismë mishëron me plot të drejtë kuptimin se koha, qartësia e mandatit dhe përgjegjësia personale në nivelin më të lartë janë vetë instrumente

të paqes. Prandaj, është njëkohësisht privilegj dhe nder të shpreh gatishmërinë time të plotë për të kontribuar në këtë përpjekje të rëndësishme dhe për t’u bërë tërësisht pjesë e një angazhimi të përbashkët që synon ta përkthejë vizionin në veprim”, thuhet në përgjigjen e Ramës drejtuar Trumpit, duke shtuar se Republika e Shqipërisë ka qenë prej kohësh një aleatë e palëkundur e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e lidhur

nga vlera të përbashkëta, respekt i ndërsjellë dhe një përkushtim i përbashkët ndaj lirisë, demokracisë dhe sigurisë ndërkombëtare. “Populli shqiptar do ta kujtojë gjithmonë dhe do ta çmojë vazhdimisht rolin parimor dhe vendimtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, drejt vendosjes së paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë në momente kritike të historisë sonë të përbashkët. Në këtë frymë të qëndrueshme partneriteti, dëshiroj të rritet se Republika e Shqipërisë qëndron me vendosmëri përkrah Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në të gjitha përpjekjet për promovimin e paqes, sigurisë dhe angazhimit konstruktiv global. Duke pritur me interes të kontribuoj në suksesin e misionit të Bordit të Paqes, ju lutem pranoni, Zoti President dhe Kryetar i Bordit, shprehjen e konsideratës sime më të lartë. Me respekt, Edi Rama”, thuhet në përgjigjen e kryeministrit Rama drejtuar Trumpit.

KURTI NË SHTËPINË E SHBA-SË NË DAVOS: BESIMI ËSHTË SHTYLLË E SHËRBIMIT DHE UNITETIT SHOQËROR

DAVOS, 20 JANAR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë në panelin e diskutimit me temë “Besimi, lidhshëria dhe Amerika 250”, në Shtëpinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Davos. Gjatë diskutimit Kurti ka theksuar rolin e besimit si element kyç në ndërtimin e shërbimit dhe unitetit në shoqëri dhe në funksionimin e shtetit. “Besimi shërben si shtyllë e shërbimit dhe unitetit në etapa të ndryshme shoqërore dhe shtetërore”, ka deklaruar Kurti, duke shtuar se optimizmi për të ardhmen buron nga angazhimi dhe aktivizmi i vazhdueshëm. Sipas tij, përpjekjet e vazhdueshme për përmirësim dhe bashkëpunim janë faktorë



kyç që ushqejnë shpresën dhe besimin për të ardhmen. Paneli ku mori pjesë Kurti është pjesë e iniciativës së Forumit Ekonomik Botëror, “Komuniteti i besimit në veprim”, e cila synon të nxisë

reflektim mbi mënyrën se si udhëheqësit nga vende të ndryshme të botës mund të ndërtojnë partneritete inovative në fushat e mjedisit, ekonomisë dhe teknologjisë.

Gjatë një bisede me Rory Stewart OBE në “Shtëpinë e Kosovës” në kuadër të Forumit Ekonomik Botëror në Davos, Zvicër, Kurti ka folur për qeverisjen e deritanishme, planet ekonomike, politike dhe gjeo-strategjike të Kosovës.

Kurti ka theksuar se prioritet i qeverisë së tij ka qenë rritja e cilësisë së shërbimeve, transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve. Ai ka deklaruar se nuk lejohet asnjë lloj korrupsioni brenda kabinetit qeveritar. “Ne e kemi trashëguar një situatë me korrupsion endemik. Ka rezistencë e qëndrueshmëri të fortë të njerëzve që të mos kthehen kurrë më aty. Pra shpresa jonë janë njerëzit, që ata do ta

njoftojnë sistemin dhe publikun për korrupsionin që e hasin”, ka thënë ai, teksa ka shtuar se qeverisja e tij ka qenë shembull. Kurti ka folur edhe për politikat sociale, investimet kapitale dhe ekonomike që qeveria e tij ka implementuar, si dhe për bllokadën politike disamujore që çoi në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, ku LV-ja ka fituar 51 për qind të votave. Ai ka përmendur edhe sfidat e sigurisë, duke kritikuar planet destabilizuese të Serbisë dhe Rusisë, përfshirë luftën hibride gjatë fushatës zgjedhore. Kurti ka theksuar rëndësinë e profesionalizmit të Agjencisë së Inteligjencës për të garantuar përgjigje efikase ndaj çdo sulmi.

Në mbështetje të Osmanit edhe për një mandat të dytë, veprimtari shqiptaro-amerikan Bajraktari: Për mua Kosova është mbi gjithçka


PRISHTINË, 20 JANAR - Veprimtari i njohur i komunitetit shqiptaro-amerikan në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Harry Bajraktari, ka dalë publikisht në mbështetje të Vjosa Osmani si presidente e vendit edhe për një mandat.

Bajraktari, i cili ishte përfolur në publik si kandidat i mundshëm për president të Kosovës, përmes një video në “Facebook”, u ka bërë thirrje deputetëve, të pozitës dhe

opozitës, që të votojnë Osmanin edhe për një mandat të ri. “Për pesë vjet presidentja Vjosa Osmani ka punuar ngushtë me komunitetin shqiptaro-amerikan dhe me miqtë tanë në Uashington. Punën që kemi nisur së bashku nuk duhet të ndalet, objektivi është i qartë, anëtarësimi i Kosovës në NATO, prandaj unë e përkrahu fuqishëm edhe një mandat të dytë për presidenten Osmani. Për pesë vjet

presidentja Osmani ka përfaqësuar Kosovën me dinjitet dhe ka forcuar lidhjen me ShBA. Tani më shumë se kurrë nga duhet institucione të forta, koordinim me aleatë dhe lidhshëria që e njeh procesin. Kosova nuk fiton asgjë nga përçarjet, bllokadat apo zgjedhjet e reja. U bëj thirrje deputetëve, pozitë e opozitë, votojeni presidenten Osmani për mandat të dytë në krye të shtetit”, ka thënë Bajraktari.





VOTAT RINUMËROHEN, KOHË PËR INSTITUCIONET SHKURTOHET

PRISHTINË, 20 JANAR - Në kohën kur dukej se Kosova po shkonte drejt formimit të institucioneve të reja pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit, procesi zgjedhor u kthye disa hapa prapa. Zbulimi i mospërputhjeve serioze në votat e kandidatëve për deputetë e detyroi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të marrë vendim për rinumërim të plotë të të gjitha votave në vendvotimet e rregullta. Vendimi i marrë më 19 janar pasoi rinumërimin e pjesshëm nga java e kaluar, gjatë të cilit u evidentuan shkelje dhe dallime të theksuara, si dhe thirrjet e vazhdueshme të partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile për një rinumërim tërësor të votave. Për vëzhguesit e proceseve zgjedhore dhe zhvillimeve politike në Kosovë, ky vendim ishte i domosdoshëm për mbrojtjen e integritetit të votës, njëkohësisht hap rrezikun e vonesave të gjata procedurale dhe të një krize të mundshme institucionale.

Roli i KQZ-së dhe mundësitë për përsheptim

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)

Reagimet e partive politike

Partitë kryesore politike e mbështetën rinumërimin e plotë të votave si mënyrë për ta rivendosur besimin publik në procesin zgjedhor. Fituesja e zgjedhjeve të 28 dhjetorit, Lëvizja Vetëvendosje mbështeti rinumërimin e plotë. Anëtar i saj në KQZ, Sami Kurtshi, tha se kjo është “një gjendje faktike” kur votoi për vendimin. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri

Hamza, e përshkroi rinumërimin si “hap të domosdoshëm dhe të drejtë” për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor. Udhëheqësit e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Lumir Abdixhiku dhe Ramush Haradinaj, kërkuan më herët rinumërim të plotë, duke theksuar se vetëm ashtu mund të garantohet legjitimiteti i rezultateve.

thotë se zvarritja e rinumërimin përtej javës së parë të shkurtit mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta në certifikimin e rezultateve përfundimtare dhe, rrjedhimisht, në konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë së re.

Ai thekson se rinumërimi i votave pasohet edhe me procedura të tjera ligjore, përfshirë afatin prej dhjetë ditësh për ankesa në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) - çka e ngushton edhe më shumë hapësirën kohore për përmbylljen e procesit. Megjithatë, sipas tij, gjithçka mund të përshejtohet nëse KQZ-ja rrit kapacitetet teknike dhe njerëzore për rinumërim. “Kësisoj, besoj se me një dinamikë të tillë, KQZ-ja mund të vijojë me rinumërim të plotë... sepse deri më tash janë rinumëruar gati 600 kuti të

votimit, që nënkupton se mbeten edhe rreth 2 mijë të tjera. Në rast se dyfishohet numri i tavolinave për rinumërim, procesi mund të përmbyllet më shpejt”, shpjegon Cakolli për Radion Evropa e Lirë.

Pasojat e mundshme

Analisti i çështjeve politike, Artan Muhaxhiri, thekson se zbardhja e çdo manipulimi eventual të votave duhet të jetë prioritet i institucioneve të rendit dhe ligjit. Sipas tij, keqpërdorimet e votave ngrënë dyshime serioze se ato mund të kenë ndodhur pa udhëzime nga strukturat e partive politike. Duke iu referuar përvojës së zgjedhjeve të 9 shkurtit - pas të cilave formimi i institucioneve u zvarrit për disa muaj, për të përfunduar me zgjedhje të parakohshme më 28 dhjetor -

Muhaxhiri paralajmëron se partitë politike mund t'i shfrytëzojnë afatet ligjore për bllokada të reja institucionale. “... sepse edhe partitë duhet të sqarohen për çështjen e komisionerëve, për çështjen e manipulimit të votave. Do të krijohen pengesa të mëdha përbrenda partive - gjë që, pastaj, do të ndikojë edhe në dobësimin e tyre në raport me krijimin e koalicioneve të mundshme, ose të ndonjë strategjie në raport me Qeverinë [e ardhshme] dhe zgjedhjen e presidentit”, thotë Muhaxhiri për Radion Evropa e Lirë. “Politikanët kosovarë e kanë dëshmuar se kanë kapacitete të pafundme për bllokada dhe për krijimin e pengesave në funksionimin normal të institucioneve. Prandaj, rreziku që kjo situatë të përsëritet mbetet real”, shton ai. Të dy analistët paralajmërojnë

se nëse zinxhiri i vonesave vazhdon - nga rinumërimi tek ankesat, certifikimi dhe konstituimi i Kuvendit - vendi mund të përballet me një krizë të thellë institucionale, duke përfshirë edhe rrezikun për zgjedhjen e presidentit të ri.

Afatet ligjore dhe rreziku për zgjedhjen e presidentit

Sipas Kushtetutës së Kosovës, presidenti i ri duhet të zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës jo më vonë se 30 ditë para përfundimit të mandatit të presidentit aktual.

Presidentes Vjosa Osmani mandati i skadon më 4 prill, që do të thotë se afati për zgjedhjen e presidentit të ri ose të Osmanit edhe për një mandat të ri është 4 marsi.

Cakolli paralajmëron se në situatën aktuale, me vonesat që pritet të shkaktojnë rinumërimin dhe procedurat pasuese, Kuvendi mund të mos arrijë të konstituohet deri në atë kohë, “e lëre më të zgjidhet qeveria e re dhe të votohet presidenti i ardhshëm”.

Shqetësim të ngjashëm ndan edhe Muhaxhiri. “... do të hyjmë në një kaos ligjor, sepse as Kushtetuta e Kosovës nuk e parasheh një skenar të tillë. Do të futemi në një tunel pa asnjë

SI REAGUAN KANDIDATËT TË CILËVE IU HOQËN MË SË SHUMTI VOTA NË RINUMËRIM?

PRISHTINË, 20 JANAR - Në një kohë kur Kosova është mburrur si dhe lavdëruar nga të tjerët për mbajtje të zgjedhjeve të drejta, demokratike dhe të lira, dyshimet për manipulime me vota, veçanërisht brenda subjekteve politike, kanë nxitur rinumërim të plotë të votave për zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) njoftoi të hënën se do t'i rinumërojë të gjitha votat, pasi paraprakisht kishte vendosur t'i numëronte vetëm një të tretën e tyre.

Një hetim i Komisionit kishte gjetur mospërputhje në votat për kandidatët për deputetë dhe gjatë numërimit të pjesshëm u vërtetua se dallimet janë të mëdha në vota.

Si pasojë, prokurorët kanë filluar të mbledhin të dhëna lidhur me dyshimet për manipulime të mundshme me vota, ndërsa KQZ-ja ka shkarkuar përfaqësuesit politikë në komisionin e vet komunal në Prizren, ku dyshimet për manipulime janë të mëdha.

Kush po humbet më së shumti vota nga rinumërimi?

Me mbi gjysmën e procesit tashmë të përfunduar, rinumërimi i pjesshëm votave për kandidatët për deputetë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit tashmë ka shpërfaqur mospërputhje të shumta, me



disa kandidatë si Fetah Paçarizi dhe Nait Hasani nga Partia Demokratike e Kosovës, që kishin marrë mijëra vota më shumë sesa që u takonin gjatë numërimit fillestar. E gjithë kjo ka shkaktuar shumë reagime në vend në nivele të ndryshme, përfshirë nga vetë disa kandidatë të cilëve pas rinumërimit të pjesshëm u janë hequr nga dhjetëra deri në mijëra vota. Ndër ta ka kandidatë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Lëvizja Vetëvendosje (IV) dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Fetah Paçarizi, PDK

Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Fetah Paçarizi, tha se ajo që po ndodh gjatë procesit të rinumërimit të votave “është serioze dhe shqetësuese”. Paçarizi, të cilit iu hoqën mbi 6 mijë vota deri tani,

e mohon përgjegjësinë. “Nuk kam dhe nuk kam pasur asnjë ndikim në këtë proces dhe distancohem plotësisht nga çdo keqpërdorim apo manipulim që mund të jetë bërë në emrin tim ose në dëm të votës së lirë”, shkroi Paçarizi në “Facebook”. “Kërkoj transparencë, hetim dhe përgjegjësi. Gabimi apo manipulimi i këtij niveli është përgjegjësi shtetërore”, shtoi ai.

Nait Hasani, PDK

Kandidati tjetër i PDK-së, Nait Hasani, i cilësoi dyshimet për manipulime si “cenim i rëndë i vullnetit të lirë të qytetarëve” dhe si “sulm i drejtpërdrejtë dinjiteti politik dhe kombëtar”. “Me atë që pashë në rinumërim, votat e mia janë rritur në mënyrë të padrejtë, duke u përdorur emri im për manipulime të papranueshme zgjedhore. Ky veprim përbën jo vetëm shkelje ligjore, por edhe akt të rëndë moral dhe politik”, shkroi Hasani

në “Facebook”.

Hasani, të cilit iu kanë hequr deri tani mbi 3 000 vota, tha se “unë refuzoj kategorikisht çdo votë që nuk buron nga vullneti i lirë i qytetarit”.

Luljeta Veselaj - Gutaj, PDK

Ndërsa Luljeta Veselaj-Gutaj u ankua se “mu cenua integriteti im dhe i shtetit demokratik” dhe bëri thirrje që personat e papërgjegjshëm të vihen para përgjegjesisë. Asaj iu kanë hequr deri tani mbi 2 000 vota. “Tjetërsimin e votës e konsideroj krimin më të madh që mund t'i ndodhë demokracisë dhe rrugës sonë për një shoqëri të drejtë. Kjo nuk mund assesi të falet, dhe do të kërkoj përgjegjësi nga institucionet e drejtësisë për dëmin e shkaktuar jo vetëm ndaj integritetit tim personal e politik, por edhe të integritetit të procesit më të shenjtë që e ka vendi ynë, atij zgjedhor”, shkroi ajo në “Facebook”.

Anton Quni, LDK

Anton Quni i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) e mohoi çfarëdo përfshirje në manipulim me vota në një reagim në “Facebook”. “Dëshiroj të bëj të ditur me përgjegjësi të plotë se çdo rritje e votave në emrin tim është bërë pa dashjen dhe pa dijeni timen. Unë nuk kam kërkuar, inkurajuar apo asistuar në asnjë formë devijimin e vullnetit të

qytetarëve”, shkroi Quni.

Quni, të cilit iu kanë hequr deri tani rreth 500 vota, tha se kjo “ngritje artificiale e votave nuk përfaqëson mbështetjen time reale dhe as parimet e mia njerëzore”. Ai u shpreh “plotësisht i gatshëm” të bashkëpunojë me autoritetet për ta zbardhur “këtë skandal deri në fund”.

Driton Selmanaj, LDK

Kandidat për deputet dhe kryetar i Degës së LDK-së në Prizren, Driton Selmanaj, tha se “distancohem tërësisht nga kushdo që ka marrë guximin të tjetërsojë vullnetin e qytetarëve të komunës sonë”. “Kemi dyshimet tona që ky skenar ka qenë i mirë organizuar dhe ka përfshirë të gjithë kandidatët dhe të gjitha partitë politike për ta balancuar dhe shpërndarë abuzimin tek të gjithë, në mënyrë që të mos identifikohet lehtë si problem”, shkroi Selmanaj në “Facebook”.

Burim Ramadani, AAK

Kandidati i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Burim Ramadani, tha se “kjo është e tmerrshme! E papranueshme! E gërditshme!”. “Më fyejnë e më terrorizojnë edhe votat e shtuara, edhe votat e hequra”, shkroi Ramadani në “Facebook” duke mohuar përfshirjen. Ramadani, i cili nuk arriti të fitonte vend në Kuvend, iu kanë hequr mbi 150 vota deri tani.

dritë, sepse askush nuk do të ketë mundësi institucionale ta zhblllokojë situatën”, thekson Muhaxhiri.

Ai shton se krijimi ose jo i një krize të tillë institucionale mbetet “në ndërgjegjen e partive politike”, të cilat mund të ndikojnë në përshpejtimin ose vonesën e të gjitha procedurave.

Si mund të shmangët kriza?

Ekspertët e proceseve zgjedhore paralajmërojnë se për të shmangur një krizë institucionale, partitë politike duhet t'i përshpejtojnë procedurat e rinumërimit dhe ta shmangin përdorimin e afateve për bllokada. Sipas tyre, edhe presidentja e vendit dhe partitë duhet të sigurojnë konsensus për konstituimin e Kuvendit dhe formimin e qeverisë së re.

Përndryshe, vonesat në këto procese, theksojnë ata, mund të

kenë edhe pasoja ekonomike për Kosovën. Në këtë aspekt, rreziku më i madh lidhet me mosmiratimin e buxhetit të shtetit deri më 28 shkurt. Pas kësaj date nuk mund të merren vendime për lëvizje të mjeteve financiare, përfshirë pagat, pensionet dhe pagesat për kategoritë sociale.

Në rrezik mund të vihen edhe disa marrëveshje ndërkombëtare që kërkojnë dritën jeshile nga Kuvendi. Për shembull, afati i fundit për hyrjen në fuqi të marrëveshjes me Bankën Botërore, e cila parasheh financimin e politikës zhvillimore për efektivitetin fiskal, konkurrueshmërinë dhe rritjen e gjelbër, është 13 shkurti. “Barra e përgjegjesisë bie mbi vetë partitë politike, sepse, fundja, vetë KQZ-ja është trup politik i përbërë prej tyre. Vendimet për udhëheqjen dhe përmbylljen e procedurave sa më shpejt që është e mundur, janë në diskrecionin e tyre”, përfundon Cakolli.

Dita e tetë, vazhdon procesi në QNR, rinumërohen 688 nga 2 557 vendvotime

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njofton se në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve është duke vazhduar numërimi i fletëvotimeve sipas listës së vendvotimeve për të cilat KQZ ka marrë vendim që të rinumërohen. Nga fillimi i këtij procesi (e martë, 13 janar 2026, ora 18:00) dhe deri më tani (e martë, 20 janar 2026, ora 10:00) janë rinumëruar 688 nga 2 557 vendvotime, të cilat u takojnë komunave: Deçan (5/51), Gjakovë (15/145), Gllogoc (7/73), Gjilan (13/130), Dragash (57/57), Istog (6/62), Kaçanik (45/45), Klinë (6/63), Fushë Kosovë (6/62), Kamenicë

(5/50), Mitrovicë e Jugut (10/102), Leposaviq (25/25), Lipjan (9/85), Novobërdë (2/23), Obiliq (3/33), Rahovec (8/78), Pejë (14/139), Podujevë (11/110), Prishtinë (26/262), Prizren (235/235), Skenderaj (72/72), Shtime (34/34), Shtërpçë (2/17), Suharekë (9/89) dhe Ferizaj (63/152).

Sipas këtyre të dhënave, deri më tani rinumërimi është përmbyllur plotësisht në 6 komuna.

Sipas vendimit të parë të KQZ-së, më 13 janar 2026, në 10 komuna ishte planifikuar të rinumëroheshin 100 % të vendvotimeve (Dragash, Kaçanik, Lespoviq, Prizren,

Skenderaj, Shtime, Ferizaj, Vushtrri, Mamushë dhe Ranillug), ndërkaq në 28 komunat e tjera, vetëm nga 10 % e vendvotimeve (Deçan, Gjakovë, Gllogoc, Gjilan, Istog, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Shtërpçë, Suharekë, Viti, Zubin Potok, Zveçan, Malishevë, Junik, Hani i Elezit, Graçanicë, Partesh, Klllokot dhe Mitrovicë e Veriut). Pas vendimit të dytë të KQZ-së, më 19 janar 2026, në proces të rinumërimit do të përfshihen edhe vendvotimet tjera të këtyre komunave.

KOMF SHPREH SHQETËSIM PËR DYSHIMET SE NJË INDIVID KA OFRUAR BARNA PËR ‘SHËRIMIN’ E FËMIJËVE ME AUTIZËM

PRISHTINË, 20 JANAR - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë (KOMF) ka shprehur shqetësim të thellë dhe indignim lidhur me raportimet në medie se një individ dyshohet se ka ofruar barna për “shërimin” e fëmijëve me autizëm. KOMF-i ngre alarmin dhe u bënë thirrje organeve të rendit dhe drejtësisë që të ndërmarrin urgjentisht veprimet dhe masat sipas legjislacionit në fuqi për të ndaluar dhe ndëshkuar veprimet e tilla të rrezikshme për shëndetin e fëmijëve dhe njëherësh të paligjshme. “KOMF reagon edhe ndaj përhapjes së pretendimeve të pabazuara

shkencërisht që autizmin e paraqesin si diçka që mund të ‘shërohet’. Qasje të tilla janë jo vetëm mashtruese, por edhe të rrezikshme, sepse devijojnë vëmendjen nga nevojat reale të fëmijëve: mbështetje profesionale, ndërhyrje të strukturuar, mjedise stimuluese dhe shërbime të bazuara në evidencë. Promovimi i premtimeve mashtruese shkakton dëm direkt: krijon pritshmëri joreale, shton stigmatizimin e fëmijëve dhe presionin mbi familjet e tyre, dhe nxit keqkuptim për nevojat reale të fëmijëve me autizëm”, thuhet në reagimin e KOMF-it.

KOMF-i thekson urgjencën e informimit të përgjegjshëm, përmirësimin e politikave publike dhe investimin në kapacitete dhe shërbime që fuqizojnë fëmijët me autizëm dhe familjet e tyre. “Vetëm përmes qasjeve të bazuara në shkencë, etikë dhe solidaritet shoqëror mund të krijohet një mjedis që respekton zhvillimin, dinjitetin dhe të drejtat e fëmijëve me autizëm. Çdo përpjekje për manipulim, mashtrim apo eksperimentim mbi fëmijët me autizëm është i papranueshëm dhe duhet të ndëshkohet nga organet e drejtësisë”, thuhet në reagimin e KOMF-it.



ALKETA GASHI SHPALLET ‘GAZETARJA E VITIT 2025’ NGA ORPHEUS TEXTS



PRISHTINË, 20 JANAR - Gazetarja e Radio Televizionit të Kosovës (RTK), Alketa Gashi Fazliu, është shpallur fituese e çmimit “Orpheus Texts Journalist of the Year 2025”, një vlerësim ndërkombëtar që i jepet për përkushtimin e saj të vazhdueshëm ndaj gazetarisë profesionale, etike dhe në shërbim të interesit publik. Çmimi është dhënë nga Mundus Artium Press, me seli në Universitetin e Teksasit në Dallas, e cila ka vlerësuar raportimin e paanshëm dhe të verifikuar me rigorozitet të Gashi Fazliut, si dhe respektimin e standardeve të larta profesionale. Sipas Komisionit Përzgjedhës të Orpheus Texts, puna e saj karakterizohet nga qartësi analitike dhe ndjeshmëri humaniste, veçanërisht në mbulimin e zhvillimeve politike dhe shoqërore në Ballkan. Sipas Orpheus Textsm, gjatë karrierës së saj Alketa Gashi Fazliu ka raportuar për çështje politike, shoqërore, kulturore dhe arsimore që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën publike. “Gazetaria e saj dallohet për transparencë, drejtësi dhe fokus

të qartë në interesin publik, duke kombinuar verifikimin e fakteve me thellësi kontekstuale”. Përveç angazhimit individual, sipas Orpheus Texts, ajo është vlerësuar edhe për kontributin në forcimin e kulturës profesionale në redaksi dhe për lidërshpin bashkëpunues. Paralelisht me punën në transmetime, Gashi Fazliu, mbetet aktive në shkrim dhe kërkim, me botime dhe vlerësime profesionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në arsyetimin e tij, Komisioni vlerësues ka theksuar se “Alketa Gashi Fazliu mishëron idealet më të larta të gazetarisë dhe me punën e saj përforcon rolin thelbësor të mediave të pavarura në shoqëritë demokratike”. Alketa Gashi Fazliu punon në RTK prej gati dy dekadash, me përvojë në edicionet qendrore informative, programet e mëngjesit dhe gazetarinë kulturore, përfshirë mbulimin letrar. Veprimtaria e saj përfshin edhe realizimin e dokumentarëve, ekspozitave dhe botimin e librave në fushën e gazetarisë memoriale, thuhet në Orpheus Texts.

Zemaj: Sektori i shëndetësisë ndodhet në nivelin më të ulët të përgjegjësisë institucionale

PRISHTINË, 20 JANAR - Ish-ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se sektori i shëndetësisë ndodhet në nivelin më të ulët të përgjegjësisë institucionale. Ai ka thënë se çdo ditë ka nga një skandal të ri dhe afera të rënda, paçka kërkon hetim të plotë dhe të pavarur për të gjitha këto afera. “Sektori i shëndetësisë ndodhet në nivelin më të ulët të përgjegjësisë institucionale.

Degradimi i ndodhur gjatë këtij mandati qeverisës po lë pasoja afatgjata, të vështira për t’u riparuar. Çdo ditë një skandal i ri. Çdo ditë një aferë më e rëndë se tjetra. Ndërkohë, profesionistët shëndetësorë dhe stafi janë nën presion të papranueshëm nga klikat qeverisëse, duke ju cenuar dinjitetin dhe duke krijuar mundësi për abuzuesit në emër të shëndetësisë profesionale. Kjo situatë nuk

mund të vazhdojë më. Kërkohet hetim i plotë dhe i pavarur për të gjitha këto afera”, ka shkruar Zemaj në “Facebook”. Zemaj ka thënë se veprimi i paktë i përgjegjësisë janë dorëheqjet. “Dorëheqjet janë veprimi me i paktë i përgjegjësve. Shëndetësia është shërbim jetik, jo mjet për abuzim për interesa personale e të parapolitikës së partisë”, ka shkruar Zemaj.



RINUMËRIMI DHE RREZIKU I KOLAPSIT NË KONSTITUIMIN E INSTITUCIONEVE



Shkruan: Ibrahim GASHI

Procesi i konstituimit të institucioneve pas zgjedhjeve ka hyrë në një fazë të prolongimit të pashmangshëm, duke krijuar një zinxhir vonesash që po rrezikon jo vetëm funksionalitetin institucional, por edhe stabilitetin financiar dhe kushtetues të vendit. Shkaku fillestar i këtij prolongimi lidhet

me procesin e rinumërimit të votave të kandidatëve në nivel vendi, një proces që, edhe në skenarin më optimist, do të shtyjë certifikimin e rezultateve zgjedhore për së paku dy javë shtesë. Nëse certifikimi i rezultateve përfundon vetëm pas kësaj periudhe, atëherë konstituimi i Kuvendit nuk mund të ndodhë para datave 10-15 shkurt. Ky afat, që tashmë duket realist, përfaqëson vetëm hapin e parë të një procesi shumë më kompleks dhe të mbushur me paqartësi. Konstituimi formal i Kuvendit është kushti bazë për çdo veprim të mëtejshëm institucional, por edhe ky hap përballët me një të panjohur të madhe: çështjen e nënkryetarit

të Kuvendit nga Lista Serbe, e cila aktualisht është në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje është faktor kyç që mund ta përshpejtojë ose ta bllokojë edhe më tej procesin. Në rast se kjo çështje zgjidhet brenda një afati relativisht të shkurtër dhe Kuvendi arrin të konstituohet plotësisht, atëherë hapet rruga për fazën tjetër, formimin e Qeverisë. Edhe në këtë skenar pozitiv, krijimi i Qeverisë nuk mund të pritë para datave 20-25 shkurt, duke e vendosur vendin në një garë të rrezikshme me kohën. Rreziku më i madh në këtë kronologji të ngjeshur lidhet me buxhetin e shtetit. Afati i fundit, 28 shkurti, për miratimin e

buxhetit nga Kuvendi është një vijë e kuqe institucionale. Nëse deri në këtë datë Kuvendi nuk arrin të votojë buxhetin, vendi përballët me një kolaps buxhetor, me pasoja të drejtpërdrejta për funksionimin e administratës publike, pagesën e pagave, pensione dhe financimin e shërbimeve bazë. Një situatë e tillë do të prodhonte jo vetëm krizë financiare, por edhe destabilizim politik dhe social. Si të mos mjaftonte kjo, brenda të njëjtës periudhë kritike, deri më 5 mars, vendi duhet të përmbushë edhe një obligim tjetër kushtetues: zgjedhjen e Presidentit të ri. Ky proces kërkon një Kuvend funksional, shumicë parlamentare dhe një

minimum konsensusi politik. Në kushtet e vonesave të grumbulluara dhe tensioneve politike, zgjedhja e Presidentit rrezikon të shndërrohet në një tjetër nyje bllokuese të sistemit. Si përfundim, vendi po hyn në një periudhë të ndjeshme ku çdo vonesë shtesë prodhon pasoja të shumëfishta. Prolongimi i konstituimit të institucioneve nuk është më thjesht një çështje teknike apo procedurale, por një sfidë serioze për stabilitetin kushtetues, financiar dhe politik të shtetit. Menaxhimi i kësaj krize kërkon përgjegjësi politike, koordinim institucional dhe një qasje urgjente për të shmangur një spirale bllokadash që mund ta çojë vendin në një krizë të thellë institucionale.

LDK-JA THËRRET KUVENDIN E PARTISË MË 31 JANAR, ABDIXHIKU PRITET TË KËRKOJË VOTËBESIM

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 JANAR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) do ta mbajë Kuvendin e partisë më 31 janar, ku kryetari i partisë, Lumir Abdixhiku, do ta kërkojë votëbesimin e delegatëve, ka njoftuar zëdhënësi i kësaj partie, Besian Mustafa.

Mustafa tha për gazetarë se vendimi për mbajtjen e Kuvendit u mor gjatë një mbledhjeje të Kryesisë së partisë në Prishtinë.

LDK-ja, partia më e vjetër në Kosovë, është duke përjetuar një ndër periudhat më të vështira në historinë e vet, pasi zgjedhjet e parakohshme të 28 dhjetorit sollën rezultatin e dytë më të keq për të.

Disa anëtarë të partisë, përfshirë Hykmete Bajramin - e cila dha dorëheqje të parevokueshme nga pozita e nënkryetares të partisë - kërkuar largimin e Abdixhikut, pasi LDK-ja doli e treta duke i fituar vetëm rreth 13 për qind të votave.

Mustafa tha se anëtarët e LDK-



së zhvilluan “një diskutim gati 4 orësh, të hapur e demokratik, duke shtjerrë debatin në secilën pikë të mundshme dhe duke analizuar edhe rezultatin e zgjedhjeve të 28 dhjetorit”. Më vonë, Abdixhiku shkroi në “Facebook” se “pas diskutimit të hapur dhe të përgjegjshëm, morëm vendimin që Kuvendi i LDK-së të thirret më 31 janar,

aty ku, sipas statutit dhe traditës sonë demokratike, vendoset për çështjet më të rëndësishme të partisë”. “Në LDK nuk i ikim asnjëherë përgjegjësisë. As kur është e lehtë, e sidomos kur është e vështirë. Sepse kjo shtëpi nuk është ndërtuar për rehati personale, por për shërbim dhe për përgjegjësi ndaj një ideali më të

madh se secili prej nesh. Prandaj, me përgjegjësi përballëmi; para anëtarësisë”, ka shkruar ai. Abdixhiku nuk përmendi votëbesim apo dorëheqje, por javë më parë ai kishte thënë se po ofronte dorëheqje dhe se do të largohej vetëm nëse Kuvendi i partisë voton për shkarkimin e tij. Mustafa theksoi të hënën se Abdixhiku, i cili e mori

drejtimin e partisë më 2021, do ta kërkojë votëbesimin në Kuvendin e 31 janarit. “Kjo është formë që e kërkon vetë kryetari i partisë Lumir Abdixhiku. Në këtë Kuvend do të kërkojë votë të votëbesimit. Pra, Kuvendi i cili ka 355 delegatë do të vendosë për këtë kërkesë nëse do të kenë akoma besim në kryetarin Lumir Abdixhiku. Pra, është kërkesë për votëbesim”, ka thënë Mustafa.

I pyetur nëse do të ketë garë për kryetar të ri të partisë, nëse shkarkohet Abdixhiku, Mustafa tha se është herët të flitet për këtë. “Duhet të ketë një proces tjetër për të ardhur deri të kandidaturat e tjera për të pasur një proces zgjedhor në LDK. Tani jemi të pjesa e votëbesimit. Do ta shohim rezultatin e votëbesimit së pari”, ka thënë Mustafa.

Ndërkohë Abdixhiku nënvizoi pas mbledhjes së Kryesisë se Kuvendi i 31 janarit “nuk është krizë, por mundësi”. “Mundësi për t’u dëgjuar, për t’u bashkuar rreth vlerave tona dhe për të dalë më të fortë nga ky proces”, ka shtuar ai.

Hamza takon ambasadorin Blaj, kërkon mbështetjen e Sllovenisë për rrugën evropiane të Kosovës

PRISHTINË, 20 JANAR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ka pritë në takim ambasadorin e Sllovenisë në Kosovë, Borut Blaj. Gjatë takimit është diskutuar për zhvillimet aktuale politike në Kosovë, për marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet dy vendeve dhe proceset me interes të

ndërsjellë.

Hamza e ka njoftuar ambasadorin Blaj për situatën politike dhe qëndrimet e PDK-së lidhur me stabilitetin institucional dhe orientimin euroatlantik të vendit.

Kryetari Hamza ka shprehur mirënjohjen për rolin e ambasadës sllovene në Kosovë dhe kontributin e saj të

vazhdueshëm në forcimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Sllovenisë si dhe për mbështetjen ndaj Kosovës në proceset ndërkombëtare. Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka vlerësuar mbështetjen e Sllovenisë dhe mbetet e angazhuar për forcimin e partneritetit me vendet mike dhe aleate të Kosovës.



AKB-ja alarmon: Vendimi për pagën minimale u bë pa dialog dhe po shtyn bizneset drejt informalitetit

PRISHTINË, 20 JANAR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka vlerësuar se përmirësimi i mirëqenies së punëtorëve dhe rritja e pagës minimale është një qëllim i drejtë dhe i nevojshëm në funksion të zhvillimit social dhe ekonomik të vendit. Megjithatë, AKB-ja ka shprehur shqetësimin e saj lidhur me mënyrën se si është marrë vendimi për rritjen e pagës minimale, pa konsultime paraprake me sektorin privat, pa një analizë të plotë të ndikimit financiar dhe pa vlerësim të rrezikut që ky vendim paraqet për mikro-ndërmarrjet dhe ndërmarrjet e vogla të cilat përbëjnë

shumicën e ekonomisë së Kosovës. “Mungesa e një analize gjithëpërfshirëse rrit rrezikun që një pjesë e bizneseve, të paafta për të përballuar kostot shtesë, të shtyhen drejt informalitetit, duke cenuar qëllimin e deklaruar të këtij vendimi”, ka theksuar kryetari i AKB-së, Agim Shahini, duke shtuar se AKB-ja nuk është kundër rritjes së pagës minimale, por ka kërkuar që vendime të tilla të rëndësishme të merren përmes dialogut social, në bashkëpunim me përfaqësuesit e biznesit dhe sindikatat dhe të shoqërohen me masa lehtësuese fiskale apo

mbështetëse, veçanërisht për bizneset e vogla. Në të njëjtën kohë, AKB-ja ka shprehur indinjatën e saj për faktin se edhe në këtë rast veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nuk janë përfshirë apo trajtuar me politika të veçanta mbështetëse, pavarësisht rolit dhe sakrificës së tyre për lirinë e vendit. “Çdo reformë sociale dhe ekonomike duhet të reflektojë drejtësi dhe ndjeshmëri ndaj kësaj kategorie. AKB-ja fton Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve që të rihapë dialogun me sektorin privat dhe të ndërmarrë hapa



konkretë për të siguruar që rritja e pagës minimale të jetë e qëndrueshme, e zbatueshme

dhe pa pasoja negative për ekonominë formale”, ka thënë Shahini.

SËRISH PROBLEME ME RRYMË NË KOSOVË

PRISHTINË, 20 JANAR - Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut në Kosovë (KOSTT) njoftoi se shteti po përballet me probleme të furnizimit me energji elektrike. Përmes një njoftimi më 20 janar, KOSTT tha se po përballet me vështirësi në balancimin e sistemit energjetik, për shkak të, siç u shpreh, devijimeve të mëdha midis energjisë së nominuar dhe kërkesës reale. Energjia e nominuar është parashikimi që bën Operatori për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) se sa energji u duhet konsumatorëve. “Sot KESCO ka nominuar rreth 26.17 për qind më pak energji sesa kërkesa reale, duke e çuar zonën e kontrollit KOSTT në jobalanc mesatare prej rreth 211 MW në orë, ndërsa në disa orë këto jobalanca tejkalojnë 260 MW në orë. Kjo situatë është e papranueshme dhe cenon stabilitetin e sistemit elektroenergetik”, u tha në njoftim. KOSTT-i kërkoi që nominimet të reflektojnë “saktë kërkesën reale” duke kërkuar korrigjim të menjëhershëm në mënyrë që të ruhet siguria e sistemit



energjetik. “Në këtë situatë, KOSTT është detyruar që të kërkojë aplikimin e kufizimit të ngarkesës, si masë e fundit për garantimin e operimit të sigurt, deri në përmirësimin e gjendjes”, u tha në njoftim. Qytetarët në Kosovë janë përballur me mungesë të energjisë elektrike edhe në të

kaluarën. Rasti i fundit ishte në dhjetorin e vitit 2025, kur autoritetet bënë thirrje për kursim të energjisë elektrike në orët e pikut. Kosova prodhon pjesën më të madhe të energjisë elektrike përmes dy termocentraleve të vjetra, Kosova A dhe B. Përmes këtyre dy

termocentraleve, që funksionojnë me thëngjill, Kosova prodhon 94 për qind të energjisë, apo rreth 800 megavate në orë, ndërsa pjesa tjetër sigurohet përmes energjisë së gjelbër, përkatësisht nga hidrocentralet, turbinat e erës dhe panelet diellore.

Qeveria në detyrë e Kosovës ka thënë se vetëm më 2025 ka ndarë miliona euro për rehabilitimin e tyre. Por, ish-ministri i Energjisë në Kosovë, Ethem Çeku, i tha Radios Evropa e Lirë në fund të dhjetorit 2025, se thelbi i krizës së energjisë është mungesa e investimeve kapitale në sektorin e energjisë dhe pamundësia për tërheqjen e investitorëve të mëdhenj. Ai i ka cilësuar investimet në këtë sektor si “arna-arna”, duke shtuar se paratë e shtetit shkojnë kryesisht në blerje të energjisë dhe kjo, sipas Çekut, është politikë e gabuar. Të dhënat e Doganës së Kosovës tregojnë se vendi ka importuar rrymë në vlerë të rreth 248 milionë eurove në periudhën janar-nëntor 2025, ndërsa ka eksportuar në vlerë të rreth 48 milionë eurove. Importin Kosova e ka siguruar kryesisht nga Maqedonia e Veriut, në vlerë të 114 milionë eurove dhe nga Shqipëria në vlerë të 94 milionë eurove, ndërsa ka importuar në vlera nga 3-4 milionë edhe nga Sllovenia, Serbia dhe Danimarka.

Ministria e Financave thotë se vetëm disa kategori të pensionistëve lirohen nga paraqitja e rregullt

PRISHTINË, 20 JANAR - Ministria e Financave njoftoi se vetëm disa kategori të caktuara të pensionistëve të Kosovës janë të liruar nga detyrimi për t'u paraqitur rregullisht në zyrat e pensioneve për të dëshmuar se janë gjallë në mënyrë që të mos u ndalet pagesa mujore. Në një njoftim në “Facebook”, Ministria e Financave tha se përfutuesit e pensioneve kontributpagues, pjesërisht kontributpagues dhe pensioneve familjare, nuk detyrohen të paraqiten çdo gjashtë muaj në zyrat e pensioneve. “Pensionistët e kategorive të tjera vazhdojnë të kenë obligim për paraqitje

sipas legjislacionit në fuqi”, thuhet në njoftim. Pensionistët e kategorive të tjera - përfshirë atë të pensionit të moshës bazë nga i cili përfiton çdo kosovar që ka mbushur moshën 65-vjeçare, pavarësisht se e ka qenë i punësuar apo jo, duhet të vazhdojnë të paraqiten në zyrat e pensioneve çdo gjashtë muaj. Ministria e Financave tha se është duke ndërmarrë hapa të vazhdueshëm për t'i lehtësuar shërbimet për pensionistët. “Kjo përfshin ekipet mobile që ofrojnë shërbime në shtëpi për ata që nuk mund të paraqiten fizikisht, në të

shtatë rajonet e Kosovës, thjeshtësimin e procedurave për personat paraplegjikë, tetraplegjikë dhe të verbër, duke eliminuar proceset e panevojshme dhe të lodhshme të rivlerësimit”, thuhet në njoftim. Ky vendim vjen një muaj pasi Gjykata Supreme i shfuqizoi disa nene të një udhëzimi administrativ për procedurat e lajmërimit, suspendimit nga pagesa dhe kthimit të mjeteve. Në vendimin e saj, Supremja kishte gjetur se ligji nuk e detyron pensionistin të kontributpagues të lajmërohet çdo 6 muaj. Deri para vendimit të gjykatës,



pensionistët e të gjitha kategorive ishin detyruar të paraqiteshin fizikisht në zyrat e pensioneve çdo gjashtë muaj për të dëshmuar se janë gjallë në mënyrë që të vazhdonin ta pranonin

pagesën mujore. Pensioni i moshës në Kosovë është 150 euro, ndërsa pensioni kontributpagues sillet nga 218 deri në 318 euro në muaj, varësisht shkallës së arsimit.

‘FRIKA E KUQE’ QË FSHIU ‘PERSONIN MË TË FAMSHËM ME NGJYRË NË AMERIKË’

Nga: Matt GLAZEBROOK / BBC

Paul Robeson ishte superyll i skenës dhe ekranit, një futbollist i talentuar dhe krijues i hiteve muzikore. Pastaj, mes "zjarrmisë antikomuniste" në ShBA gjatë Luftës së Ftohtë, erdhi një rënie dramatike nga lavdia.

Balada për amerikanët [Ballad for Americans] e Paul Robesonit ishte hit i papritur i muzikës pop. Një kantatë patriotike popullore që zgjaste 10 minuta, ofronte një version gjithëpërfshirës të historisë amerikane, nga formimi i saj i zjarrtë (Më '76 qielli ishte i kuq) deri tek e tashmja shumetnike, siç artikulohej nga një rrëfyes që zbulon veten të jetë vetë Amerika.

Megjithatë, kur baritoni i njohur interpretoi për herë të parë këngën në një transmetim radiofonik kombëtar në CBS në vitin 1939, u bë menjëherë sensacion. Audiencia në studio duartrokiti për 20 minuta. Letrat dhe telefonatat përmbytën stacionin dhe emisioni u përsërit gjatë gjithë vitit pasues. Tashmë një yll i skenës, ekranit dhe fushës së futbollit amerikan, transmetimi dhe publikimi i mëvonshëm i Baladës për amerikanët përforcuan statusin e Robesonit si personi më i famshëm me ngjyrë në Amerikë.

Vetëm një dekadë më vonë, ai ishte etiketuar jo vetëm si "anti-amerikan", por edhe si një person në fakt inekzistent - i ndaluar nga televizioni, i fshirë nga tekstet shkollore, me pasaportën e revokuar. Teksa Lufta e Ftohtë merrte hov dhe elita politike e kulturore e ShBA-së përfshihej nga zjarrmia antikomuniste, aktiviteti për të drejtat civile dhe solidariteti socialist i Robesonit e bënë atë objektiv kryesor.

Ai vdiq më 23 janar 1976, 200 vjet pas lindjes së përgjakshme të ShBA-së dhe 50 vjet më parë këtë muaj. Dekadat e tij të fundit u shënuan nga sëmundja dhe izolimi, pasojë e një fushate shtypjeje që ishte pa precedent mes ndalimeve të përhapura në industrinë e argëtimit që karakterizuan "Frikën e kuqe" [Red Scare]


Paul Robeson lindi më 1898 në Princeton të Nju-Xhersit, më i vogli nga pesë fëmijët. Babai i tij pastor e mbajti familjen pa nëna e tij vdiq në një zjarr shtëpie pak vite pas lindjes së tij. Të thuash se Robeson ishte një i ri i jashtëzakonshëm do të ishte nënvlerësim i madh. Ai shkëlqeu në aspektin akademik, në sport dhe në art gjatë gjimnazit në Nju-Xhersit.

Ai fitoi një bursë katërvjeçare në Universitetin e Ratgersit nga i cili doli me nderimet më të larta akademike dhe mbajti fjalimin e diplomimit. U nderua me 15 vlerësime [varsity letters], përfshirë në bejsboll, basketboll, shtizë, disk dhe hedhje sferë. Por, në futbollin amerikan ai u bë vërtet një yll, duke u përzgjedhur dy herë në ekipin premtues [All-American], përpara se të luante në

mënyrë profesionale - për të financuar studimet në Fakultetin e Drejtësisë në Kolumbia në fillim të viteve '20 të shekullit XX. Walter Camp, eksperti kryesor i futbollit në ShBA, e quajti Robesonin "mbrojtësin më të madh që ka shkelur ndonjëherë fushën".

Duke jetuar në Harlem në kulmin e Rilindjes së Harlemit, Robesoni përdori gjithashtu kohën e tij në Kolumbia për të nisur aktrimin, si dhe për të kënduar në klubin e famshëm "Cotton Club". Karriera e tij juridike përfundoi papritur jo shumë kohë pas diplomimit, kur ai dha dorëheqjen nga një firmë ligjore, në shenjë proteste, pasi një sekretare e bardhë refuzoi që ai t'i diktonte. Në vend të kësaj, u bë interpretues me kohë të plotë, i mbështetur fillimisht financiarisht nga gruaja e tij, Eslanda, drejtoreshë e laboratorit të patologjisë në Spitalin Presbiterian të Nju-Jorkut. Ai luajti në dy drama të Eugene O'Neillit (Të gjithë fëmijët e Zotit kanë flatra dhe Perandori Xhons), incizoi albume të ashtuquajturave shpirtërore të zezakëve [Negro spirituals] dhe hapi mjuziklin e ri të Oscar Hammersteinit dhe Jerome Kernit, Shfaqja lundruese [Show Boat], në vitin 1927, duke kënduar Lumin Plak [OI' Man River], këngë që u vlerësua shumë nga kritika.

Ai filloi gjithashtu të udhëtonte në Mbretërinë e Bashkuar dhe Evropë. Në vitin 1930, e interpretoi Othellon në Teatrin e Savoit të Londrës, duke u bërë aktori i parë me ngjyrë që e bënte këtë në kryeqytetin britanik - që nga Ira Aldridge një shekull më parë. Dhe, pasi kaloi pjesën më të madhe të dekadës së hershme duke interpretuar jashtë vendit, u kthye në ShBA për të luajtur në versionin filmik të Holivudit të Shfaqjes lundruese në vitin 1936. Ngjitja e tij në statusin e një ylli të kategorisë A ishte e plotë. Në vitin 1928, revista New Yorker e kishte cilësuar atë si "premtimi i racës së



tij", "Mbret i Harlemit" dhe "idhull i njerëzve të tij".

Në realitet, gjatë ngritjes së tij drejt famës, Robesoni kaloi shumë kohë duke u edukuar dhe duke u bërë gjithnjë e më i zëshëm për kontekstin më të gjerë të luftës së njerëzve me ngjyrë. Në Evropë, ai dha shfaqje bamirësie për minatorët uellsianë, refugjatët hebrej dhe luftëtarët republikanë në Luftën Civile Spanjolle. Ai studioi gjuhë afrikane dhe shkrime marksiste, dhe vizitoi Bashkimin Sovjetik. Në ShBA ai refuzoi të interpretonte për audiencën të ndara sipas racës, iu bashkua grevave të sindikatave dhe, në fushatën presidenciale të vitit 1948, mbështeti Partinë Progresive të Henry Wallaceit. Megjithatë, të gjitha këto kauza ishin relativisht të padëmshme për Robesonin - derisa e mbajti një fjalim më 20 prill 1949 në Paris. Kongresi Botëror i Përkrahësve për Paqen ishte një mbledhje me rreth dy mijë shkencëtarë, mësues, aktivistë dhe artistë nga 75 vende, i thirrur për të dënuar garën e armatimit të Luftës së Ftohtë dhe atë që ata e shihnin si agresion të ShBA-ve ndaj Bashkimit Sovjetik. "Është e paimagjinueshme që zezakët amerikanë të shkojnë në luftë në emër të atyre që na kanë shtypur për breza", deklaroi



Robesoni gjatë një greve të sindikatave (Getty Images)

Robesoni para të mbledhurve të krahut të majtë, "kundër një vendi [BRSS] i cili brenda një brezi e ka ngritur popullin tonë në dinjitetin e plotë të njerëzimit".

Rreth gjashtë vjet përpara bojkotit të autobusëve në Montgomeri dhe lindjes së lëvizjes moderne për të drejtat civile, Robesoni sugjeroi një formë rebelimi të njerëzve me ngjyrë që i tejkalonte objektivat asimiluese të NAACP-së (Shoqata Kombëtare për Avancimin e Njerëzve me Ngjyrë) - që ishte organizata dominuese në atë kohë. Reagimi, si nga liberalët kryesorë ashtu edhe nga antikomunistët konservatorë, ishte i menjëhershëm dhe dërmues.

Disa muaj pas ngjarjes në Paris, Paul Robeson tentoi dy herë të jepte një koncert për pushuesit në kampet verore socialiste hebraike pranë Piskillit në Nju-Jork, ashtu siç kishte bërë edhe në verat e mëparshme. Dy herë, mijëra veteranë lokalë të luftës protestuan dhe trazirat shpërthyen: protestuesit sulmuan pjesëmarrësit me gurë, shkopinj dhe grushte, përmbysën makinat dhe plagosën 150 persona, ndërsa policia qëndroi duke parë. Ndërkohë që kjo përpjekje e dhunshme për ta "anuluar" Robesonin u dënuua gjerësisht dhe nuk u përsërit më, një version më i fshehtë ndëshkimi filloi menjëherë pas kësaj.

Në mars të vitit 1950, NBC e ndaloi të shfaqej në emisionin televiziv të Eleanor Rooseveltit, Sot me zonjën Ruzvelt [Today With Mrs Roosevelt], pas protestave nga organizata Legjioni Amerikan (një organizatë e veteranëve të luftës) dhe të tjerëve. Pastaj, në korrik, Departamenti i Shtetit ia revokoi pasaportën, duke e penguar të performonte jashtë vendit ku ai vazhdonte të ishte jashtëzakonisht i njohur. Në ShBA, karriera e tij ishte de fakto e përfunduar. Shtëpitë diskografike refuzuan të nxirrmin në treg disqet e tij të vjetër ose të incizonin të rinj. Nga një prej dhjetë artistëve më të paguar në ShBA në vitin 1941 dhe duke fituar 100 mijë dollarë nga koncertet deri në vitin 1947, nga viti 1952 ai mezi arrinte të fitonte gjashtë mijë dollarë në vit.

Teksti i Baladës për amerikanët u hoq nga tekstet shkollore dhe poeti Langston Hughes u detyrua të fshinte çdo përmendje të Robesonit nga libri i tij Krijues të famshëm të muzikës zezake

[Famous Negro Music Makers], përndryshe rrezikonte ndalimin e tij në bibliotekat shkollore. Emri i tij u fshi në mënyrë retroaktive nga listat e fituesve të çmimeve të NAACP dhe kampionëve të futbollit njësoj. Madje, po të kishe thjesht një disk të Paul Robesonit - siç kishin qindra mijëra amerikanë - mjaftonte që një punonjës shtetëror të merrte një "shënim të zi" gjatë intervistave për besnikëri që zhvilloheshin në vitet '50 të shekullit XX.

Ylli i bejsbollit, Jackie Robinson, u thirr përpara Komitetit të Dhomës për Aktivitetet Jo-Amerikane (HUAC) për t'u distancuar nga deklaratat e Robesonit në Paris dhe, në mënyrë të tërthortë, për të ndarë publikun me ngjyrë prej tij. Më në fund, në vitin 1956 vetë Robesoni u paraqit përpara HUAC-së. Pa asnjë ndjesë, ai u tha anëtarëve të komitetit:

"Ju jeni jo-amerikanë".

Në librin e saj Krimet janë të shumta [Many Are the Crimes], historiania e Luftës së Ftohtë, Ellen Schrecker, pohon se "ndoshta asnjë individ tjetër nuk u censurua kaq rëndë" sa Paul Robesoni. Dhe, në disa mënyra, ai paraqiste vërtet një kërcënim unik. Jo si spion, por si socialist i zëshëm me ngjyrë. Një njeri që e lidhte luftën e afro-amerikanëve për të drejtat civile me kauzën e klasës punëtore në mbarë botën - nga luginat e Uellsit deri në Afrikën Perëndimore, nga Misisipi deri në Moskë. Dhe, nga të gjithë ata që u përjashtuan (nga skenaristët e Holivudit te nëpunësit civilë dhe akademikët), askush nuk ishte kaq i njohur apo dikur kaq i dashur. Siç thotë Schrecker: "Aktori dhe këngëtar i më karizmatik me ngjyrë i brezit të tij ishte shndërruar në jo-person". Pasaporta iu kthye Robesonit më në fund në vitin 1959 dhe ai u përpoq të niste sërish një turne ndërkombëtare. Por, i lodhur nga vitet e luftës dhe ballafaqimit, përpjekjet e tij u ndaluan nga episode sëmundjeje dhe depresioni. Nga mesi i viteve '60 të shekullit XX, ai pushoi së dhëni koncerte dhe, pas vdekjes së Eslandas, vitet e mbetura i kaloi nën kujdesin e motrës së tij. Në vitin 1973, ai iu drejtua një eventi që e nderonte [Salute to Paul Robeson] në Karnegi-Hall të Nju-Jorkut. Ai deklaroi se ishte "po aq i përkushtuar sa gjithmonë ndaj kauzës botërore të njerëzimit për liri, paqe dhe vëllazëri", ripohonte angazhimin e tij ndaj luftës së afro-amerikanëve për të "arritur çlirim të plotë nga sundimi racist", dhe nderonte lëvizjet anticolonialiste në mbarë botën. Ai e përfundoi mesazhin e tij me fjalët në vazhdim: "Edhe pse shëndeti i dobët më ka detyruar të tërhiqem, mund të jeni të sigurt se në zemrën time unë vazhdoj të këndoju:

Por, vazhdoj të qesh

Në vend që të qaj,

Duhet të vazhdoj të luftoj

Derisa të vdes,

Dhe Lumi Plak

Vazhdon rrjedhën!"

/Telegrafi/



- Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




www.facebook.com/gieipuneshpeite

SWISS
TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898



Sallon Depilimi Lume's Details



lumesdetails



Abirpa Teatr-it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

**KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË**

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të datës 19.01.2026 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M. "Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 20.01.2026 të shpall:

KONKURS

Tre (3) Punëtor Fizik- Njësia në Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Numri i referencës: 19-01-52

Lartësia e pagës mujore: 496.69 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen të gjitha punët në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave në automjete – kamion kompaktor dhe traktor;
- Brazren e konteinerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre nga zona e shërbimit gjërë në deponi;
- Kryen pastrimin, larjen dhe spërkatjen e sipërfaqeve publike, rrugëve dhe shesheve;
- Kryen punët e grumbullimit të mbeturinave në konteiner, kryen punët rreth pastrimit të borës, hedhjes së kripës industriale, heqjen e akullit;
- Është i obliguar të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorimin të kujdesshëm të konteinerëve gjatë punës, kryen edhe punë tjera të natyrës së ngjashme të cilat i cakton udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë.

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit.

Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe vlerësohet nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës).

Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatë fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatet më me se shumti pike të grumbulluara nga procesi i vlerësimit. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulimi për aplikim i KRM "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Çertifikatë mjekësore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstraktit të lindjes,
- Dëshmi nga gjykatë se nuk jeni i dënuar (më e re se 6 muaj).

Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Atari dhe mënyra e Aplikimit:
Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 20.01.2026 deri me 03.02.2026, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M. "Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj" p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.

Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enkel Shala shpall te pavlefshme 3 dëftesat , certifikatën dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Garip Rizanaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Etrit Rizanaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Gentian Muhadri nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Pjeter Bogdani” Damjan Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.
- Krenar Abrashi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit “Krenar Abrashi” B.l. me nr. Unik: 811133719.
- Fitore Rexhepi shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greiçevci”.
- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohu-ni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sal-lon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numre të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales


Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





Kosova ngjitet në pozitën e 79 në ranglistën e FIFA-s

PRISHTINË, 20 JANAR - Kombëtarja e Kosovës ka shënuar ngritje në ranglistën e re të FIFA-s e cila u publikua të hënën pasdite, vetëm një ditë pas përfundimit të Kupës së Afrikës. Nga vendi i 80 në

dhjetor, Kosova tashmë është ngjitur në pozitën 79, që përbën renditjen më të mirë në histori për "Dardanët". Kjo lëvizje u mundësua edhe nga rënia e Gabonit për tetë pozita, pas humbjes së tri ndeshjeve në

Kupën e Afrikës, duke u vendosur në pozitën e 86. Si rezultat, disa kombëtare, përfshirë Kosovën, kanë fituar nga një apo dy pozita. Në muajin mars Kombëtarja dardane përballet me sfidën

historike të "play-off"-it për Kupën e Botës 2026. Më 26 mars Kosova luan gjysmëfinalen kundër Sllovakisë në Bratislavë. Fituesi i këtij dueli do të përballet në finale me Turqinë ose Rumaninë.



'TË HARMONIZUAR', FFK-ja DHE AGIM ADEMI I KUNDËRPËRGJIGJEN MKRS-së

PRISHTINË, 20 JANAR - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) para disa ditësh përmes një shkrese zyrtare ka theksuar se Federata e Futbollit e Kosovës nuk mund ta mbajë Kuvendin Zgjedhor më 5 shkurt pasi, sipas saj, duhet t'i plotësojë disa kritere të cilat i ka listuar në shkresën e saj. Pas kësaj shkrese ka ardhur reagimi nga Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) dhe nga presidenti i kësaj federate, Agim Ademi. Fillimisht, FFK-ja ka publikuar një video nga

Kuvendi i fundit i mbajtur, në të cilën është thënë se kanë miratuar ndryshimet statutorë të harmonizuara plotësisht me Ligjin e ri të Sportit si dhe me kërkesat e UEFA-s dhe FIFA-s. Ndërsa presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka postuar një foto së bashku me presidentin e UEFA-s, Aleksandër Ceferin si dhe me presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino, në përvjetorin e themelimit të Federatës së Futbollit të Hungarisë. "Të harmonizuar, UEFA, FIFA dhe FFK", ka shkruar Ademi në "Facebook".



KOKAJ DHE KRYEZIU PËRFAQËSOJNË KOSOVËN NË OLIMPIADËN E DIMRIT



PRISHTINË, 20 JANAR - Kiana Kryeziu dhe Drin Kokaj do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Olimpike Dimërore Milano Cortina 2026, ka njoftuar Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK).

Kryeziu ka përmbushur kriteret bazë të kualifikimit në tri disiplina të skijimit alpin: sllalom, sllalom të madh dhe super sllalom të madh, disiplina në të cilat do të garojë në Milano Cortina.

Ndërkohë, Drin Kokaj ka siguruar kualifikimin për ta përfaqësuar Kosovën në sllalom. Në garë për kualifikim ishin edhe Lirika Deva, e cila nuk i ka plotësuar kriteret në sllalom dhe sllalom të madh, si dhe Vokshi në sllalom të madh. "Sipas rregullave, Kosova mund të përfaqësohet në Lojërat Olimpike Dimërore me nga një garues për secilën gjini. Në këtë rast, Kryeziu kishte më

shumë disiplina në të cilat u kualifikua, ndërsa Kokaj ka pikë më të ulta kundrejt Vokshit, në disiplinën e sllallomit", ka njoftuar KOK-u. Kiana Kryeziu ka përfaqësuar Kosovën edhe në Lojërat Olimpike Dimërore Pekin 2022, ndërsa për Drin Kokajn, Milano Cortina 2026 do të jetë paraqitja e parë olimpike. Lojërat Olimpike Dimërore Milano Cortina do të mbahen nga 6 deri më 22 shkurt 2026.

Myrto Uzuni drejt Serisë A, flet edhe për Evropianin e për Botërorin

TIRANË, 20 JANAR - Viti 2026 është një ndër vitet më të rëndësishme për kombëtaren kuqezi ku do të luajë më 26 mars ndeshjen e "play-off"-it të Botërorit për herë të parë në histori duke pasur ende shans për t'u kualifikuar për në fazën finale. Mes protagonistëve të këtyre eliminatorëve të Botërorit të vitit të shkuar ishte Myrto Uzuni. Për herë të parë, si lojtar i kampionatit amerikan, i cili është pushim në këtë periudhë dimërore në Evropë, i ka dhënë mundësinë atij të qëndrojë gjatë në vendlindjen e tij, Berat dhe ta

shijojë famën e arritur si futbollist i kombëtares tashmë. "Nga vij unë e vetmja mënyrë në shtëpi për të mbijetuar ka qenë futboll. Jam shumë krenar për veten time që ia arrita falë sakrificave të familjes sime dhe falë njerëzve si Polizon Kuqei, ish-trajneri i Beratit që më ka ndihmuar, më ka dhënë rrogën e parë 175 mijë lekë dhe isha njeriu më i lumtur në botë, pasi mami më thoshte lëre futbollin se s'kam ilaç t'i lajmë rrobat, pasi fushat ishin me baltë", ka thënë Uzuni. Por, rreth dy vjet më parë

Uzuni ishte një ndër të përjashtuarit për në finalen e Evropianit, Gjermani 2024, një peng i karrierës së tij. "Unë besoj gjithmonë tek vetja ime, punoj fort dhe i dedikoj të gjithë kohën. Normalisht pjesa e Evropianit ka atë boshllëkun e vet në shpirtin tim, por uroj ta plotësoj me Botërorin", ka thënë Uzuni. Sa i përket kundërshtarit të radhës së "play-off"-it, Uzuni ka shprehur besim. "Normalisht nuk ka më ekipe të forta apo të dobëta, ne nuk po luajmë kundër Anglisë apo Gjermanisë, po luajmë ndaj



Polonisë, një ekip shumë i vështirë. Unë mendoj se shanset i kemi 50 me 50", ka

thënë Uzuni.

Uzuni ka edhe tri vjet kontratë me Austin në ShBA, por Cagliari është një ndër skuadrat e interesuara, por jo vetëm. Atë e kanë joshur për një rikthim në Evropë edhe pse fakti që ka një kontratë e bën lojtarin kuqezi të rezervuar të flasë hapur. "Varet ku do të ishte mundësia, në çfarë kampionati do të jetë kërkesa, por me këto gjëra merret menaxheri dhe ai më pas, i mbledh dhe zgjidhet opsioni më i mirë për mua", ka thënë Uzuni.